



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 323/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Nenad Laziç dhe Rafet Haxhaj anëtarë, dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi lidhur me ankesën e Isen Çerkezi – Kryesues në KVV nr.1501c/072 dega në Obiliq, paraqitur kundër Koalicionit PDK-AAK-NISMA dega në Obiliq, për shkak të pa rregullsive gjatë procesit zgjedhor në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit i mbajtur me datë 14.06.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**HUDHET** si e pasafatshme ankesa Anr.323/2017 të datës 13.06.2017, parashtruar nga Isen Çerkezi – Kryesues në KVV nr.1501c/072 dega në Obiliq, për shkak të parregullsive gjatë procesit të votimit me datë 11.06.2017.

### A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 13 qershor 2017, nga Isen Çerkezi – Kryesues në KVV nr.1501c/072 dega në Obiliq, me të cilën pretendon se në të njëjtin KVV, në Obiliq, gjatë bartjes së votave të kandidatëve për deputet nga radhët e koalicionit PDK-AAK-NISMA është bërë një gabim teknik, pasi që nga numëri 106 dhe deri në numërin 110 renditja është bërë gabim. Parashtruesi i ankesës PZAP-it i ka kërkuar që të merret për bazë ankesa dhe ta bëjë rinumërimin e votave, pasi që këto pretendime ankimore i mbështesim me dëshmi shtesë. Në cilësi të provës parashtruesi i ankesës si dëshmi i ka bashkangjitur 2 fletë – kopje të rezultateve zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës .

PZAP-i, pasi që shqyrtoi afatshmërin e ankesës, gjeti se :

#### **Ankesa është e pasafatshme**

Për të gjitha parregullsitë që mund të paraqiten në ditën e votimit, ankesa mund të paraqitet në PZAP, brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së Qendrës së Votimit sipas nenit 5.3 të Rregullorës Nr.02/2015. Në rastin konkret ashtu siç del nga ankesa e njëjta është dorëzuar në PZAP, nga parashtruesi i ankesës me datë 13.06.2017. Nga përmbajtje e ankesës rezulton se të gjitha pretendimet ankimore të parashtruara nga ankuesit ndërlidhen me procesin e votimit.

Nga kjo rezulton se ankesa e lartpërmendur është dorëzuar në PZAP, pasi që ka kaluar afati ligjorë për të parashtruar ankesa në PZAP, për parregullsitë në ditën e votimit sipas dispozitës së lartcekur ligjore, kjo nga fakti se afati për paraqitjen e ankesës ka

qenë me datën 12.06.2017 deri në ora 19:00, ndërkaq ankuesit ankesën e tij e ka parashtruar në PZAP me datë 13.06.2017, që do të thotë se ankesa është parashtruar pas afatit ligjor të përcaktuar me dispozitën ligjore të nenit 5.3 të Rregullorës Nr.02/, lidhur me nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015.

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lart ne kuptim të nenit 118 dhe 119 të LZP-së dhe nenin 6 par.4 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 323/2017 më datën 14.06.2017



*Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apel, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.1 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*